



Datë: 02.04.2025

Numër protokolli: 2187/2025

A.nr.334/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.334/2025, të datës 19.02.2025, të parashtruar nga ankuesi O.Sh, kundër organit të punësimit: Kuvendi i Republikës së Kosovës në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.334/2025, e datës 19.02.2025, e parashtruar nga ankuesi O.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesi, O.Sh. (me tej referuar vetëm ankues), më datë 19.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.334/2025, kundër vendimit të datës 19.02.2025, të nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 10.03.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A. Nr.334/2025 të datës 19.02.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 19.02.2025, i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Akt Emërimi me numër protokoli AE. Nr. 325/2017, i datës 10.10.2023, për O.SH; E-mali i datës 19.02.2025; Kopje e letërnjoftimit për O.Sh; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër 334/2025, e datës 10.03.2025; Diplomë me numër protokoli 1238, e datës 10.10.2011, për O.SH, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Njoftim për kontratë i datës 27.01.2025; Raporti i vlerësimit të tenderëve; E-mali i datës 19.02.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Akt Emërimit nr.325/2017 të datës 10.10.2023, është i punësuar në pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor”, Njësia për Mbështetjen e Kryesisë së Kuvendit dhe Seancës Plenare, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me koeficient të pagës 5.85.

Tutje, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes vendimit të datës 19.02.2025, ankuesin e cakton anëtar të Komisionit për Vlerësimin e dosjes së Aktivitetit të Prokurimit “Sigurim shëndetësor jashtë vendit për udhëtime të Deputeteve, Stafit Politik dhe Administratës së Kuvendit të Kosovës.

Ankuesi O.Sh., i pakënaqur me vendimin e datës 19.02.2025, të nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me datë 19.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 19.02.2025, të nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me pretendimet ankimore, se sa i përket caktimit tim në këtë Komision, është pa bazë ligjore sepse unë në pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor”, në Drejtorinë për Çështje Plenare dhe Procedurale, përkatësisht në Njësinë për Mbështetjen e Kryesisë së Kuvendit, nuk kam kualifikimin e duhur dhe së nuk me është ofruar asnjë trajnim për çështjen e prokurimit, po ashtu Drejtoria dhe Njësia në të cilën shërbej nuk ka të beje asgjë me aktivitetet e prokurimit e as me këtë vendim lidhur me udhëtimet zyrtare dhe duke marr parasysh së Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës e ka Drejtorinë e Prokurimit, aktivitetet e tilla duhet ti kryejë me stafin e vet të përgatitur e të certifikuar për procedurat e prokurimit, duke pretenduar së në këtë komision është dashur që të caktohen zyrtaret tjerë me shumë përvojë në udhëtime zyrtare.

Kolegji i Këshilli në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 05/I-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/I- 237 dhe me ligjin nr. 05/I-068, përkatësisht nenit 59, ku përcaktohet se; 1. *Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, ndërlidhur me nenin 40, paragrafi 40. 1, dhe paragrafi*

40.3 të Rregullores nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku përcaktohet së; *Komisioni Vlerësues është përgjegjës për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP, 40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve, gjithashtu Kolegji ju referu edhe nenit Neni 39 Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve 39.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht “ZKA” në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione rekomandues për Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit.... 39.2 Komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast në varësi të aktivitetit të prokurimit. 39.3 Parimet në vijim përbëjnë bazën për formimin dhe funksionimin e komisionit të tillë: (i) Anëtarët e komisionit do të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë që nënkupton që personat të cilët janë të implikuar në të paktën njërin nga kushtet në vijim nuk janë të pranueshëm: a. është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare b. është deklaruar i papërshtatshëm, aty ku autoriteti kontraktues konstaton të ketë përbërë shkelje të rënde profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente c. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato, ose d. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale, ose f. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër”, prandaj bazuar në konstatimet ligjor Kolegji i Këshillit konstaton së Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 19.02.2025, ku përmes këtij vendimi ankuesin e cakton anëtar i Komisionit për Vlerësimin e dosjes së Aktivitetit të Prokurimit “Sigurim shëndetësor jashtë vendit për udhëtime të Deputeteve, Stafit Politik dhe Administratës së Kuvendit të Kosovës, ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, gjithashtu Kolegji ju referua edhe pikës 39.9 Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ku përcaktohet se : „ AK ka të drejtë të angazhojë ekspert të jashtëm, në rastet kur kërkohet njohuri dhe ekspertizë e veçantë teknike ose e specializuar varësisht nga objekti i prokurimit dhe që ekspertët të tillë nuk janë në dispozicion brenda AK. Ekspertët e tillë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP-se njëjtë si anëtarët e komisionit të vlerësimit nga AK., andaj në kuptim të këtyre dispozitave në rastin konkret autoriteti kontraktues gjegjësisht Kuvendi i Kosovës nuk e ka vlerësuar se ka të bëjë me një dosje të tenderit ku kërkohet njohuri dhe ekspertizë e veçantë teknike ose e specializuar dhe rrjedhimisht as ankuesi nuk ka ndonjë arsyetim të qëndrueshëm që mund ta të refuzoj emërimin në cilësinë e anëtarit në këtë Komision.*

Kolegji i Këshillit i ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se nuk kam kualifikimin e duhur dhe së nuk i është ofruar asnjë trajnim për çështjen e prokurimit, mirëpo Kolegji konstaton se asnjë dispozitë ligjore nuk obligon që anëtarët e komisionit të kenë ndonjë trajnim për të caktuar në komisionin për vlerësimin dhe ekzaminimin e dosjeve të tenderit.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 334/2025

Rushit Kajtazi

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit O.Sh;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Njësisë për Burime Njerëzore në Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së